



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr.116 Akti

Nr.124 Vendimi

Tiranë, më 26.03.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bektoshi	Kryesuese
Suela Zhegu	Anëtare
Xhensila Pine	Relatore

në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, më datë 21 mars 2019, ora 11:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Z. Çlirim Shahini, prokuror dhe drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen, duke u bazuar në të dyja kriteret e vlerësimit, në atë pasuror e në atë të figurës, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016,

V Ë R E N:

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Çlirim Shahini, ushtron detyrën e prokurorit dhe të drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Çlirim Shahini, i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur, në datën 15.01.2018, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

3. Në referim të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, procesi ndaj subjektit të rivlerësimit ka filluar menjëherë pasi janë caktuar me short trupat gjykuese të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe është shpërndarë me short çështja konkrete.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues, në datën 22.03.2018, u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues, znj. Brunilda Bekteshi. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi konfliktin e interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

5. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (në vijim ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Prokuroria e Përgjithshme (në vijim PP).

6. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

7. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me atë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, si dhe ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar *papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Çlirim Shahini.*

8. Prokuroria e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

9. Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

10. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, në datën 27.02.2019, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit mbi kriterin e kontrollit të figurës dhe kriterin e vlerësimit të pasurisë, dhe njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

11. Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit, në datën 27.02.2019.

12. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së shpjegimeve të tij, në datën 14.03.2019.

13. Pas administrimit dhe shqyrtimit të shpjegimeve dhe të provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

14. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore përmes njoftimit elektronik në datën 19.03.2019. Në shpjegimet e sjella në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit i paraqiti trupit gjykues kërkesën për përfshirjen edhe të komponentit të tretë, atë të vlerësimit profesional, për të, si subjekti i rivlerësimit. Trupi gjykues, në prani edhe të përfaqësuesit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, vendosi, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, të mos e pranojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit, pasi për komponentët e figurës dhe të pasurisë provat kishin nivelin e provueshmërisë sipas ligjit nr. 84/2016 dhe subjekti i rivlerësimit, me shpjegimet e paraqitura, nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës.

Subjekti i rivlerësimit u njoftua për këtë vendim në seancën dëgjimore. Marrja e vendimit për përfundimin e procesit të rivlerësimit për subjektin Çlirim Shahini, për kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të vlerësimit të pasurisë, nuk përbën në asnjë rast gjë të gjykuar (*res judicata*) për kriterin e vlerësimit profesional.

II. SEANCA DËGJIMORE

15. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në datën 21.03.2019, në orën 11:00, në Pallatin e Koncerteve, kati 0, salla B, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin.

16. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojti personalisht dhe shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

17. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni është një proces Kushtetues, i cili mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës si dhe në ligjin nr. 84/2016. Në referim të dispozitave ligjore kushtetuese dhe të ligjit nr. 84/2016, si dhe të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nr. 2 dhe 17 të vitit 2017, Komisioni, në mënyrë të pavarur dhe të paanshme ka kryer një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. KONTROLLI I FIGURËS

18. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikojë nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 02.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, rishikuar në datën 16.08.2018, nr. *** prot. Në përfundim, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka konstatuar *papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Çlirim Shahini.*

19. Bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenet A, Ç, DH, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në nenet 34 – 39, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në vendimet nr. 2 dhe 17 të vitit 2017 të Gjykatës Kushtetuese, në vijim të procesit të kontrollit të figurës Komisioni kreu një hetim administrativ të thelluar për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Çlirim Shahini, me qëllim verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve dhe kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me parashikimet ligjore, nga ku rezultoi se:

20. Faktet nga hetimi administrativ

21. Subjekti i rivlerësimit në pyetësorin standard ka deklaruar se:

*“Në datën 10.02.2013, kam marrë në përdorim mjetin, me targë ***, mjet në pronësi të shtetasit A.D., lindur dhe banues në fshatin Mursi, Sarandë, për të lëvizur në Greqi”.*

22. Në lidhje me këtë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *“Personat, të cilëve u kam marrë mjetet në përdorim, kanë qenë persona të njohur nga ana ime”.*

Nga ana e Komisionit, është kryer një hetim i thelluar, në lidhje me shtetasin A.D., prej të cilit ka rezultuar se ky shtetas ka ndërruar emër, pasi më parë ka mbajtur emrin N.D.

23. Në lidhje me këtë shtetas kanë rezultuar disa procedime penale si më poshtë:

Procedim penal, nr. ***, datë 09.12.2014; akuza: pastrim i produkteve të veprës penale, sipas nenit 287 të Kodit Penal. Në datën 19.06.2015 është vendosur pushimi i procedimit nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë, pasi nuk është bërë e mundur të provohet nëse shtetasi A.D. të ketë kryer ndonjë vepër penale.

Me vendimin nr. ***, datë 29.09.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, shtetasi N.D. është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale të “Dhënie ndihmë për kalimin e paligjshëm të kufirit”, parashikuar nga neni 298/3 të Kodit Penal.

Nga procesverbali i datës 23.04.2008 për arrestimin në flagrancë, rezulton se z. N.D. ka qenë i dënuar më parë në shtetin grek për trafikim të lëndëve narkotike.

Bazuar në procesverbalin të datës 23.04.2008, për deklarin nga persona ndaj të cilëve zhvillohen hetime, z. N.D. deklaroi se: “... jam kthyer në Shqipëri para tre vjetësh pasi kam dalë nga burgu, ku kam vuajtur dënimin për 9 vjet për veprën penale të transportit të bimëve narkotike”.

24. Bazuar në vendimin për bashkimin e procedimit, të datës 15.05.2008, të subjektit të rivlerësimit me anë të të cilit ai ka vendosur të bashkojë procedimin nr. ***, me procedimin nr. ***, në ngarkim të shtetasit S.M. Në procedimin nr. *** si i pandehur rezulton dhe N.D., në të cilin vërtetohet edhe dijenia e subjektit të rivlerësimit për veprimtaritë kriminale të këtij shtetasi.

25. Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5, të nenit Ç dhe DH, të Aneksit të Kushtetutës, barra e provës iu kalua subjektit të rivlerësimit për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, pasi duket se ai ka pasur kontakte të papërshtatshme me një person të përfshirë në krimin e organizuar.

26. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit sqaroi se në pyetësorin standard të deklarimit ka deklaruar se në datën 10.02.2013 ka marrë në përdorim mjedin me targë *** në pronësi të shtetasit A.D., lindur dhe banues në fshatin Mursi, Sarandë, për të lëvizur në Greqi. Me z. A.D. nuk ka pasur kontakte por njohje në distancë. Ka qenë duke frekuentuar kafën e mëngjesit në lokalin afër gjykatës dhe prokurorisë Sarandë, lokal të cilin e frekuentonim i gjithë stafi i gjykatës dhe prokurorisë. Ky lokal është në pronësi të z. L. (V.) S., me të cilin ka konsumuar një problem familjar (vizitë mjekësore për bashkëshorten) dhe i ka kërkuar mjedin e tij, pasi lëvizte shpesh për në Greqi. L. (V.) S. u shpreh se nuk kishte siguracion për në Greqi, por i ka ofruar makinën e të njohurit të tij (bashkëshortin), të z. A.D., mjedi i të cilit ishte i pajisur me dokumente të rregullta për të lëvizur jashtë shtetit. Në mungesë të dokumenteve të makinës, Z. A.D., pa i kushtuar shumë rëndësi, ka bërë aktin noterial dhe ka marrë mjedin e të sipërpërmendurit. Kur është kthyer nga Greqia, çelësat e makinës ia ka lënë z. L. (V.) S., i cili ka qenë në mbrëmje te lokali i tij. Për të qenë korrekt, të nesërmen e ka falënderuar shtetasin A.D., janë përshëndetur dhe nuk i ka lidhur asnjë lloj kontakti tjetër. Gjithashtu nuk ka pasur asnjë ndikim nga personi në fjalë në punën e përditshme.

27. Arsyetimi ligjor

28. Duke pasur parasysh: (i) deklarinimet e subjektit të rivlerësimit në Deklaratën e Kontrollit të Figurës “Vetting”; (ii) raportet e DSIK-së; (iii) provat shkresore dhe faktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe në seancë dëgjimore, Komisioni arsyeton se:

29. Neni DH, paragrafi 2, i Aneksit të Kushtetutës, parashikon se: “*Subjektet e rivlerësimit plotësojnë dhe i dorëzojnë Komisionit një deklaratë të detajuar për figurën e tyre, që mbulon periudhën nga data 1 janar 2012 deri në ditën e deklarimit sipas ligjit*”.

30. Më tej, neni DH, paragrafi 4, i Aneksit të Kushtetutës parashikon se: *“Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të bëjë deklarime të pasakta, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”*.

31. Subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të deklarimit të kontaktit të papërshtatshëm me shtetasin N. (A.) D.

Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, nuk përputhen me deklaratimet e tij në pyetësonin standard, në të cilin ai ka deklaruar që shtetasit të cilëve u ka përdorur mjetet kanë qenë persona të njohur nga ana e tij.

32. Për sa kohë që nga ana e subjektit të rivlerësimit është përdorur automjeti i këtij shtetasi, si dhe prej tij është pranuar në pyetësonin standard se ai ka njohje me këtë shtetas, deklaratimet e tij pas kalimit të barrës së provës nuk qëndrojnë.

33. Për sa më sipër, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës në lidhje me deklarimin e pasaktë në Deklaratën e Kontrollit të Figurës, deri në ditën e deklarimit, sipas parashikimeve ligjore.

34. Baza ligjore

35. Bazuar në provat dhe faktet e analizuara së bashku, trupi gjykues, arrin në përfundimin se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime të pasakta sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 4, të nenit DH, të Aneksit të Kushtetutës së Shqipërisë, duke fshehur fakte të ndodhura deri ditën e deklarimit, sipas ligjit.
- ii. Subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar Formularin e Deklarimit për Kontrollin e Figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi, në përgjigje të pyetjes të germës “ç”, të pjesës 5, të “Shtojcës 3”, “Të dhëna për sigurinë”, të ligjit nr. 84/2016.
- iii. Bazuar në nenin 61/3, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin e figurës, pasi nuk ka renditur në listë një kontakt që është konstatuar nga prova të besueshme sipas neneve 38/6/a të ligjit 84/2016.

Konkluzioni për vlerësimin e figurës

36. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Çlirim Shahini, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin e figurës, duke mos plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi dhe nuk ka renditur në listë një kontakt që është konstatuar nga prova të besueshme. Në zbatim të pikës 4, të nenit DH, të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë të kundërtën me shpjegimet dhe provat e paraqitura prej tij dhe të bindë trupin gjykues mbi pavërtetësinë rezultateve të hetimit.

B. VLERËSIMI I PASURISË

37. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja është bërë pas marrjes së deklaratës së subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, dorëzuar në ILDKPKI, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

38. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, kreu hetimin e tij të pavarur¹ dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, i cili konsistonte në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, nëse ka konflikt interesi, fshehje të pasurisë apo deklarim të rremë, në përfundim të të cilit ka rezultuar se:

I. PËR OBJEKT DY KATE + PAPAFIGO 387 M² NDËRTUAR MBI OBJEKTIN EKZISTUES TREKATËSH NË EMËR TË SHTETASIT D.M.R.,

39. Burimi i Krijimit sipas deklaratës “Vetting”: të ardhura familjare dhe huadhënieje nga z. D.P.

40. Në datën 22.03.2011 është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr. ***, midis z. D.R. dhe z. Çlirim Shahini. Sipas kësaj kontrate pala pronare vë në dispozicion të palës investitore, z. Çlirim Shahini, sipërfaqen totale prej 289 m².

41. KRRT-ja, me vendim nr. ***, datë 14.01.2011, ka miratuar sheshin e ndërtimit, destinacionin e funksionit të tij, si dhe kondicionet urbane për objektin: banesë private shtesë dy kate + papafingo mbi 3 katet ekzistuese. Sipërfaqja e sheshit 289 m²; sipërfaqja e ndërtimit 140 m².

42. Bashkia e Sarandës ka lëshuar lejen e ndërtimit në emër të subjektit ndërtues “****” sh.p.k. me afat deri më 31.12.2014. Financues rezulton subjekti i rivlerësimit.

43. Leja e ndërtimit ka dalë në emër të shoqërisë “****” sh.p.k., KRRT-ja me vendim nr. ***, datë 14.01.2011, ndërkohë që subjektit i rivlerësimit ka lidhur kontratë me këtë shoqëri në fund të vitit 2013.

44. Në datën 03.12.2013 është lidhur kontrata me objekt: “Godinë banimi dhe shërbimi me papafingo” midis subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “****” sh.p.k. Vlera e përgjithshme e kontratës është **10,520,324 lekë**.

¹ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr 2 date 18.01.2017 “41.Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga KPK-ja, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

45. Nga ana e Komisionit është bërë një hetim i thelluar në lidhje me marrëdhënien e krijuar midis subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “****” sh.p.k., si dhe midis tij dhe z. D.R. Nga hetimi ka rezultuar se:

I/A NË LIDHJE ME PERSONIN TJETËR TË LIDHUR, Z. D.R.,

Faktet nga hetimi administrativ

46. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka përdorur deri në vitin 2014, për banim banesën në emër të shtetasit D.M.R., në lagjen nr. 4, në Sarandë. Në të njëjtën banesë ai ka ndërtuar dhe dy kate + papafingo në marrëveshje me z. D.R.

47. Për të vërtetuar deklarin e tij ai ka depozituar deklaratën noteriale nr. ***, datë 24.11.2018, të shtetasit D.R., i cili deklaroi se subjektin e rivlerësimit e ka strehuar pa shpërblim për periudhën 2003 - 2015, ndërsa në një apartament me sip. 30 m² në katin përdhes të po kësaj banese ka jetuar për një periudhë dyvjeçare, znj. Sh.Sh., nëna e subjektit të rivlerësimit.

48. Duke qenë se z. D.R. ka deklaruar se e ka strehuar subjektin e rivlerësimit pa shpërblim, si dhe e ka lejuar atë të ndërtojë mbi banesën e tij, në bazë të nenit 32/3, të ligjit 84/2016, ai përfshihet në personat e tjerë të lidhur dhe duhet të justifikojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

49. Subjektit të rivlerësimit i është kërkuar informacion në lidhje me ndërtimin e godinës trekatëshe të z. D.R., si dhe të provojë burimin e ligjshëm për ndërtimin e saj. Në përgjigjen e tij ai sqaron se: *“Unë me z. D. R. kam qenë shumë i lidhur që në moshë të vogël, jemi në një moshë, marrëdhëniet e tij me vëllain e vet, z. A. R., i cili është bashkëshorti i motrës, janë shumë të mira. D., në vitin 2001 ka investuar në Sarandë godinën e sipërpërmendur. Më ka dhënë një apartament dhe në tjetrin jetonte vetë. Pas disa vitesh, duke qenë se kati i tij përdhes rrinte bosh, i kam kërkuar të jetonte nëna ime, fakt të cilin e ka pranuar dhe ka lejuar që nëna të jetonte në një garsonere me sip. 30 m² për disa vjet. Në vitin 2011, duke qenë se marrëdhëniet tona ishin tepër të mira, unë i kam kërkuar D. nëse do të ndërtonte kate të tjera në objektin e tij. Më është shprehur se nuk do të investonte më. I kam kërkuar nëse më lejonte mua të ndërtoja dhe ka shfaqur dëshirën, së bashku me familjarët e tij që të ndërtoja.”*

50. Subjekti i rivlerësimit, për të provuar deklarinet e tij, ka depozituar:

- Foto të apartamenteve në pronësi të z. D. R., leje legalizimi, kontratën e sipërmarrjes që ka lidhur me z. R., si dhe certifikatat e pronësisë të apartamenteve në pronësi të z. R.;
- Deklaratën noteriale nr. ***, datë 19.01.2019, në të cilën deklaruesit B. R., D. R., A. R. dhe S. R., deklarojnë se:

“B. dhe D. R., pas vdekjes të z. M. R., i kanë shitur A. dhe S. R., kundrejt çmimit 3,000,000 lekë, një shtëpi banimi dhe truall. Në lidhje me likuidimin e çmimit, A. dhe S. R. deklarojnë se, në vitin 2002 kanë likuiduar shumën prej 2,500,000 lekësh dhe në vitin 2006 shumën prej 500,000 lekësh. Deklaruesit deklarojnë se nuk kanë lidhur kontratë shitjeje, pasi pasuria nuk është regjistruar ende në ZVRPP”.

- Deklaratën noteriale nr. ***, datë 09.12.2013, në të cilën deklaruesit B. R., dhe A. R., deklarojnë se:

“B. R. i ka shitur A. R., në vitin 2006, një shtëpi banimi dhe truall. Aktualisht pasurinë e mësipërme e ka marrë në dorëzim A. R., e cila aktualisht banon me familjen e tij”.

- Deklaratën noteriale, nr. ***, datë 21.01.2019, të z. D. R. dhe znj. B. R., të cilët deklarojnë se:

Sipas aktit të marrjes së tokës në pronësi, nr. ***, familja e tyre me kryefamiljar, z. M. R., ka përfituar tokë bujqësore, arë, e ndodhur në Shelegar, me sipërfaqe 2700 m² dhe me sipërfaqe 4300 m², të ndodhur në fshatin Bajkaj, Delvinë.

Për arën në Shelegar me sipërfaqe 2700 m² kjo tokë ka qenë vresht, të cilën e kanë futur në prodhim që prej viteve 1991 - 2019, për 27 vjet: për periudhën 1991 - 2006 kemi marrë shumën 100,000 lekë/dynym për çdo vit, pra, 270,000 lekë, që e llogaritur për 15 vjet është shuma 4,500,000 lekë; ndërsa për periudhën 12-vjeçare, nga 2007 – 2018, kemi marrë shumën prej 85,000 lekësh dynym/vit, për çdo vit është shuma 229,500 lekë dhe në total është 2,754,000 lekë.

Për arën në Shelegar me sipërfaqe 4300 m², kjo tokë për periudhën 12-vjeçare, 1991 – 2013, është shfrytëzuar si perimore, duke marrë vlerën prej 80,000 lekësh/dynym për çdo vit, pra, 344,000 lekë, që të llogaritura për 12 vjet janë: 4,128,000 lekë.

Për periudhën 2004 - 2007, kjo sipërfaqe prej 4.3 dynymësh është marrë nga z. D. R. në vresht, dhe nga vitit 2007 që hyri në prodhim deri në vitin 2018, pra për këtë periudhë 12-vjeçare ka marrë vlerën prej 100,000 lekësh/dynym për çdo vit, pra, 430,000 lekë në total 5,160,000 lekë.

Me vetëdeklarimin për legalizim, datë 23.03.2005, ka kërkuar legalizimin e një parcele ndërtimore dhe të një objekti 3-katësh të filluar prej tij së ndërtuari në vitin 2001..., shtëpi në të cilën në katin e tretë të objektit banon me nënë dhe familjen. Në katin e parë dhe të dytë ka përshtatur pesë ambiente për t'i dhënë me qira. Vlera e shtëpisë është 6,000,000 lekë dhe 389,000 lekë tarifa e legalizimit.

- Aktin e marrjes së tokës në pronësi, nr. ***, datë 31.03.1996.

- Kthim përgjigjeje nga Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë, nr. ***prot., datë 18.01.2019, prej së cilës rezulton se z. D. R. është i regjistruar si tatimpagues me NIPT ***.

- Kthim përgjigjeje, Komisariati i Policisë Kufitare Sarandë, nr. ***prot., datë 18.01.2019, ku deklarohet se z. D. R. nuk ka në pronësi mjet lundrues.

51. I gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të ardhurat e ligjshme të z. D. R. është thjesht deklarativ dhe i pashoqëruar me dokumentacion provues nga organet tatimore, për të vërtetuar të ardhurat e deklaruara si të përfituara nga z. D. R. nga toka bujqësore. Deklarata noteriale nuk përputhet me aktin e marrjes së tokës në pronësi, pasi në deklaratë deklarohet se toka bujqësore është marrë në vitin 1991, ndërkohë që ajo është marrë në vitin 1996. Nga ana e Komisionit është bërë dhe një analizë financiare mbi burimin e të ardhurave të shtetasit D. R. për ndërtimin e godinës 3-katëshe në vitin 2001 nga ku rezulton se ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar ndërtimin e godinës 3-katëshe.

52. Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, iu kalua subjektit të rivlerësimit barra e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën për sa më poshtë:

- z. D. R., nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të ndërtuar godinën 3-katëshe në vitin 2001.
- Subjekti i rivlerësimit nuk vërteton me dokumentacion provues burimin e ligjshëm të të ardhurave të z. D. R. për të ndërtuar këtë godinë.
- Subjekti i rivlerësimit ka depozituar foto që nuk tregojnë realitetin e gjendjes së dhomave në pronësi të z. D. R..

53. Pas kalimit të barrës së provës subjekti i rivlerësimit sqaroi se, për sa i përket të ardhurave financiare në emër të z. D. R. nuk mundi të shtojë më tepër nga aktet të cilat i ka vënë në dispozicion të Komisionit. Z. D. R. ka qenë emigrant në shtetin grek për një periudhë rreth 10-vjeçare, deri në vitin 1999 apo 2000. Pasi është kthyer nga Greqia ka qëndruar shumë pak në fshatin e tij Bajkaj, Delvinë, për rreth një apo dy vjet dhe më pas, në vitin 2001, është zhvendosur me familjen në Sarandë, ku ka ndërtuar godinën 3-katëshe dhe ku banon aktualisht. Disponon, aktin e marrjes së tokës në pronësi, një sipërfaqe toke pemëtare dhe vreshtarie, të cilat i ka vënë në dispozicion të Komisionit gjatë kthimit të përgjigjes. Banesën në fshatin Bajkaj e ka shitur, vlera e banesës është e përcaktuar në deklaratën noteriale e cila është bërë pjesë e dosjes.

54. Subjekt i rivlerësimit ka shkuar për të jetuar në Sarandë në vitin 2003, ku dhe është strehuar në apartamentin e tij. Të gjitha fotot të cilat i ka dërguar pranë Komisionit, janë foto të bëra me aparatit e telefonit personal dhe janë të dokumentuara ende në telefon për kohën në të cilën janë bërë. Cilësia e fotove varet vetëm nga aparati me të cilin është bërë fotografia.

Analiza ligjore

Nga hetimi administrativ rezultoi se, ndryshe nga sa deklaroi subjekti i rivlerësimit, e gjithë godina e ndërtuar nga ai dhe z. D. R. përdoret si njësi akomoduese dhe mban emrin “***”.

55. Fotot e depozituara nga subjekti i rivlerësimit nuk janë të një cilësie të mirë, si dhe nuk përputhen me fotot e publikuara në faqe të ndryshme në internet, ku e gjithë godina, përfshirë dhe tre katet e subjektit të rivlerësimit, promovohet si hotel me emërtimin “***”. Nga fotot e publikuara në internet, të cilat janë shkarkuar dhe janë bërë pjesë e dosjes së hetimit administrativ, rezulton se dhomat janë të mobiluara dhe në gjendje shumë të mirë, fakt ky që nuk përputhet me gjendjen e pasqyruar në fotot e depozituara nga subjekti i rivlerësimit².

56. Fotot e pasqyruara në disa *website* të dhënies me qira të njëjësive akomoduese për sezonin e verës promovojnë të gjithë ndërtesën, edhe katin e fundit të kësaj ndërtese si njësi akomodimi, duke e emërtuar *penthouse*, i cili është i mobiluar në mënyrë moderne dhe është funksional.

57. I gjithë dokumentacioni i dorëzuar është thjesht deklarativ dhe i pashoqëruar me dokumentacion provues nga organet tatimore, për të vërtetuar të ardhurat e deklaruara si të përfituara nga toka bujqësore nga z. D.R. Deklarata noteriale nuk përputhet me aktin e marrjes

² https://www.booking.com/hotel/al/***.en-gb.html#rt-lightbox-open-RD242605606
https://www.agoda.com/en-sg/***/hotel/saranda

së tokës në pronësi, pasi në të deklarohet se toka bujqësore është marrë në vitin 1991 ndërkohë ajo është marrë në vitin 1996.

58. Në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave për z. D. R., subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues për të vërtetuar se z. D. R. ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të ndërtuar godinën trekatëshe.

59. Dy deklaratat noteriale: nr. ***, datë 19.01.2019 dhe nr. ***, datë 09.12.2013, nuk përputhen me njëra-tjetrën, pasi në deklaratën nr. ***, deklarohet se në vitin 2002 është paguar shuma 2,500,000 lekë, ndërsa në deklaratën nr. ***, deklarohet se shtëpia është blerë në vitin 2006.

60. Nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk është dorëzuar asnjë dokumentacion provues për të provuar:

a. çmimin e shitjes në vlerën prej 3,000,000 lekësh të kësaj banese, për më tepër, nëse i referohemi dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se kjo shumë është marrë në vitin 2002. Ndërkohë godina në bazë të deklarimeve të subjektit, deklarata noteriale e vitit 2019, nuk mund të shërbejë si provë për të provuar veprime të kryera para 17 vjetësh, ndërkohë në deklaratën noteriale nr. ***, datë 09.12.2013, nuk përcaktohet çmimi i shitjes;

b. marrjen e shumës prej 3,000,000 lekësh dhe pagimin e detyrimeve përkatëse tatimore;

c. pronësinë e D. dhe B. R. mbi këtë banesë, duke marrë në konsideratë faktin se në aktin e marrjes së tokës në pronësi, nr. ***, datë 31.03.1996 (në këtë akt nuk lexohet mirë se kush është përfituesi, pasi është i fshirë), nuk rezulton t'i jetë dhënë ndonjë sipërfaqe trualli, z. M. R. Subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar certifikatën familjare të z. M. R., në vitin 1991, për të vërtetuar se nga akti i marrjes së tokës në pronësi ka përfituar vetëm z. M. R., znj. B. R. dhe z. D. R., pasi nga vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit rezulton se z. D. R. ka të paktën dhe një vëlla tjetër z. A. R.

61. Deklarimet e subjektit nuk mbështeten në prova. Nga hetimi administrativ rezulton dhe është fakt se e gjithë godina, përfshirë edhe tre katet e subjektit të rivlerësimit, promovohet si njësi akomoduese me emërtimin “***”. Ky fakt nuk është deklaruar asnjëherë nga subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu, pavarësisht faktit se nga cili janë bërë punimet në apartamentin në pronësi të subjektit të rivlerësimit, ai kishte detyrimin ligjor për ta deklaruar një fakt të tillë në deklaratën “Vetting”, por dhe gjatë pyetësorëve.

62. Nga ana e tij është fshehur fakti se një pjesë e apartamenteve shfrytëzohej nga ana e z. D. R. gjatë sezonit të verës si njësi akomoduese. Për më tepër, ky aktivitet nuk rezulton i regjistruar pranë QKB-së, duke e vënë subjektin e rivlerësimit dhe në kushtet e fshehjes së një aktiviteti tregtar, për të cilin lindin edhe detyrime tatimore.

63. Subjektit të rivlerësimit i janë kërkuar foto të apartamenteve të tij, ku përfshihet dhe gjysma e pretenduar prej tij që i është dhënë në përdorim z. D. R. Nga ana e tij nuk është depozituar foto e kësaj gjysme, duke u fshehur ky fakt. Subjekti ka depozituar një video për të provuar sa pretendon, por trupi gjykues vlerëson se depozitimi i kësaj video nuk arrin të provojë te kunderten e barres se proves të kaluar.

Baza ligjore

64. Bazuar në provat dhe faktet e analizuara së bashku, trupi gjykues, arrin në përfundimin se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë në deklaratën “Vetting” edhe gjatë hetimit administrativ në lidhje me apartamentet në pronësi të tij, pasi nuk ka deklaruar se ato kanë destinimin të përdoren, si njësi akomoduese.
- ii. Trupi gjykues, mospërputhjet e deklaratave noteriale të sipërcituara, me shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, i çmon si fakte që vijnë në kundërshtim me parashikimet e nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.
- iii. Shpjegimet dhe provat e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit sipas nenit D, paragrafi 5, të Aneksit të Kushtetutës.
- iv. Bazuar në paragrafin 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë.

I/B NË LIDHJE ME KOHËN E NDËRTIMIT TË OBJEKTIT

Faktet nga hetimi administrativ

65. KRRT-ja, me vendimin nr. ***, datë 14.01.2011, ka miratuar sheshin e ndërtimit, destinacionin e funksionit të tij, si dhe kondicionet urbane për objektin: banesë private, shtesë dy kate + papafingo mbi 3 katet ekzistuese.

66. Sipërfaqja e sheshit 289 m², sipërfaqja e ndërtimit 140 m². Bashkia e Sarandës ka lëshuar lejen e ndërtimit në emër të subjektit ndërtues “****” sh.p.k., me afat deri në datën 31.12.2014. Financues rezultojnë subjekti i rivlerësimit.

67. Nga ana e ZVRPP-së Sarandë rezultojnë se në datën 17.06.2015, me shkresë nr. *** prot., është dërguar dokumentacioni nga ana e Bashkisë Sarandë në lidhje me këtë objekt.

68. Një ndër këto dokumente është dhe akt-kolaudimi i këtij ndërtimi, prej të cilit rezultojnë se fillimi i punimeve për këtë objekt ka qenë në vitin 2011 dhe mbarimi i punimeve në dhjetor të vitit 2013. Ky akt është firmosur nga vetë subjekti i rivlerësimit, shoqëria sipërmarrëse “****” sh.p.k., mbikëqyrësi i punimeve dhe kolaudatori.

69. Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, për sa ka rezultuar se leja e ndërtimit ka dalë në emër të shoqërisë “****” sh.p.k. që në vitin 2011, ndërkohë që subjektit i rivlerësimit ka lidhur kontratë me këtë shoqëri në fund të vitit 2013.

70. Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, sqaroi se: me kërkesën e depozituar nga subjekti rivlerësues pranë Bashkisë Sarandë, në vitin 2011, ku kryetar i Bashkisë Sarandë për vitin 2011 ka qenë z. E. Gj., është trajtuar kërkesa në KRRT. Me vendimin nr. ***, datë 14.01.2011, është miratuar leja e ndërtimit, kjo e pasqyruar sipas protokollit. Zbardhja e lejes së ndërtimit është kryer në vitin 2013, kur kryetar bashkie ka qenë z. S. Ç. Kontrata me firmën ndërtuese “****” sh.p.k. është lidhur në datën 03.12.2013.

71. Formularët, vendimi i KRRT-së dhe ai i lejes së ndërtimit, kanë qenë standard. Nëse i referohemi formularit të zbardhjes së lejes së ndërtimit, në fund, në krahun e majtë, rezulton vetëm viti 2012, pa datë. Ai as i ka kushtuar rëndësi këtij fakti, “zbardhjes së lejes së ndërtimit”. Po kështu nëse i referohemi formularit nr. ***, në vendimin e KRRT-së, nr. ***, datë 14.01.2011, në fund të formularit nuk është shënuar as data dhe as viti.

Logjika argumentuese është se, referuar materialeve të dosjes së subjektit të rivlerësimit të ndodhur në Bashkinë Sarandë, si formulari i lejes së ndërtimit është pasqyruar viti 2012, rezulton se kjo datë ka ngelur nga formularët e vitit paraardhës (lapsus nga ana e administratës bashkiake).

72. Subjekti i rivlerësimit deklaroi me përgjegjësi se leja e ndërtimit ka dalë në emër të investitorit, z. Çlirim Shahini, dhe jo në emër të shoqërisë “****” sh.p.k., dhe paraqiti tri fletë nga protokollu i mbledhjes, datë 14.01.2011, të KRRT-së Sarandë, ku pasqyrohet fakti i protokolluar në emër të subjektit rivlerësues.

73. Pasqyrimi i të dhënave të shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., është zbardhur në lejen e ndërtimit pas kontratës që ai ka realizuar me firmën ndërtuese, që mban datën 03.12.2013, pasi kjo kontratë është depozituar në dosjen të cilën e disponon edhe Bashkia Sarandë.

74. Për analogji, si mundet që bashkia do të zbardhte lejen e ndërtimit në vitin 2011 në emër të shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., pa pasur kontratë midis subjektit rivlerësues në cilësinë e investitorit dhe nga ana tjetër shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k.?

75. Ai deklaroi me përgjegjësi dhe korrektësi se leja e ndërtimit për objektin dy kate + papafingo, ndodhur në lagjen nr. ***, Sarandë, ka dalë në emër të subjektit rivlerësues, z. Çlirim Shahini, me nr. ***, datë 14.01.2011, dhe paraqiti fletë të administruara në Bashkinë Sarandë sipas procesverbalit të mbledhjes së KRRT-së, datë 14.01.2011, ku provohet fakti se leja e ndërtimit ka dalë në emër të subjektit rivlerësues, z. Çlirim Shahini.

Analiza ligjore

76. Sqarimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë bindëse dhe nuk mbështeten në asnjë provë. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se leja e ndërtimit është lëshuar në datën 14.01.2011, në emër të shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k. Argumentimi i subjektit të rivlerësimit se vendimi është zbardhur më vonë, në vitin 2013, nuk qëndron, pasi dhe në rastin kur vendimi do të zbardhej më vonë, në këtë vendim nuk mund të përfshiheshin rrethana që kanë ndodhur pas vitit 2011, për më tepër, që data e vendimit është viti 2012 dhe jo 2013.

77. Nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk është depozituar asnjë provë për të vërtetuar se zbardhja e vendimit të vitit 2011 është bërë pikërisht në fund të vitit 2013.

78. Akt-kolaudimi i këtij ndërtimi, në të cilin rezulton se fillimi i punimeve për këtë objekt ka qenë në vitin 2011 dhe mbarimi i punimeve në dhjetor të vitit 2013, firmosur nga vetë subjekti i rivlerësimit, konsiderohet si provë e cila bie ndesh me shpjegimet e subjektit të rivlerësimit.

79. Në datën 03.12.2013 është lidhur kontrata me objekt: “Godinë banimi dhe shërbimi me papafingo”, midis subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “****” sh.p.k. Vlera e përgjithshme e kontratës është në vlerën **10,520,324 lekë**. Në këtë kontratë është përcaktuar se **subjekti i rivlerësimit do të shlyente shoqërinë “****” sh.p.k., nëpërmjet sistemit bankar.**

80. Nga ana e ZVRPP-së Sarandë rezulton se, në datën 17.06.2015, me shkresë nr. *** prot., është dërguar dokumentacioni nga ana e Bashkisë Sarandë në lidhje me këtë objekt.

81. Një ndër këto dokumente është dhe akt-kolaudimi i këtij ndërtimi, prej të cilit rezulton se fillimi i punimeve për këtë objekt ka qenë në vitin 2011 dhe mbarimi i punimeve në dhjetor të vitit 2013. Ky akt është firmosur nga vetë subjekti i rivlerësimit, shoqëria sipërmarrëse “****” sh.p.k., mbikëqyrësi i punimeve dhe kolaudatori.

82. Fakti se, subjekti i rivlerësimit i ka kaluar nëpërmjet sistemit bankar shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k., shumën prej 7,600,000 lekësh në vitin 2014 dhe shumën prej 300,000 lekësh në vitin 2016, nuk është provë që provon kohën e kryerjes së ndërtimit të kësaj godine nga ana e subjektit të rivlerësimit, për më tepër ka prova të tjera që kundërshtojnë këtë fakt.

83. Në rastin konkret, rezulton nga hetimi në mënyrë të logjikshme se subjekti i rivlerësimit ka qenë i detyruar të paraqiste këtë mënyrë pagese të bërë firmës së ndërtimit për arsye të mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë. Për sa kohë që, në rastin konkret subjekti rezulton të gjendet në këtë situatë, plotësohen rekuizitat që kërkon neni D, pika 5, e Aneksit të Kushtetutës, për konstatimin e përpjekjeve në funksion të një qëllimi manipulativ.

84. Në përfundimit të hetimit dhe analizës ligjore të kryer sa më sipër, bazuar në të gjithë dokumentacionin shkresor dhe faktet e analizuara më lart, trupi gjykues, arriti në përfundimin se ndërtesa në pronësi të subjektit të rivlerësimit ka qenë e përfunduar në vitin 2013.

Baza ligjore

85. Bazuar në provat dhe faktet e analizuara së bashku, trupi gjykues, arrin në përfundimin se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë në deklaratën “Vetting” dhe gjatë hetimit administrativ, si dhe në deklaratat e interesave private të vitit 2011 - 2013, në lidhje me kohën e ndërtimit të kësaj banese.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë veprime fiktive, me qëllim fshehjen e ndërtimit të kësaj banese gjatë viteve 2011 - 2013.
- iii. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit sipas nenit D, paragrafi 5, të Aneksit të Kushtetutës.
- iv. Bazuar në paragrafin 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë.

I/C NË LIDHJE ME HUAN 2,720,324 LEKË MARRË SHOQËRISË “**” SH.P.K.**

86. Në lidhje me shlyerjen e faturave, shoqëria e ndërtimit deklaroi se ajo është shlyer plotësisht nga subjekti i rivlerësimit në fund të vitit 2016. Shuma e përgjithshme e xhiruar nga ana e subjektit të rivlerësimit ka qenë 10,520,324 lekë, e cila është likuiduar si më poshtë:

- Njoftimi debitimi, datë 26.02.2014, “Raiffeisen Bank”, me urdhërues, subjektin e rivlerësimit dhe përfitues, “***” sh.p.k., shuma 35,000 euro.

- Njoftimi debitimi, datë 05.08.2014, “Raiffeisen Bank”, me urdhërues, subjektin e rivlerësimit dhe përfitues, “***” sh.p.k., shuma 200,000 lekë.

- Njoftimi debitimi, datë 12.12.2014, “Raiffeisen Bank”, me urdhërues, subjektin e rivlerësimit dhe përfitues, “***” sh.p.k., shuma 2,200,000 lekë.

- Depozitim për të tretë në “Raiffeisen Bank”, datë 17.03.2014, me urdhërues, subjektin e rivlerësimit dhe përfitues, “***” sh.p.k., shuma 500,000 lekë. Në këtë dokument rezultoi se pagesa është bërë nga ana e z. M. M. dhe jo nga subjekti i rivlerësimit.

87. Në përgjigjet e shoqërisë së ndërtimit, administratori i saj flet në emrin e tij personal duke deklaruar se: duke qenë se shoqëria e ndërtimit kishte mbyllur likuiditetet e objektit referuar situacioneve me faturë tatimore në Degën e Tatimeve Sarandë, subjekti i rivlerësimit i detyrohej atij një shumë prej 2,700,000 lekësh si debi personale. Për këtë shumë ka rënë në marrëveshje verbale që të likuidohet gjatë viteve 2015 – 2016, sipas mundësive të subjektit të rivlerësimit. Likuidimet *cash* janë kryer si më poshtë:

Shuma prej 2,000,000 lekësh, në vitin 2015 në formën e pagesave mujore.

Shuma prej 720,000 lekësh, gjatë vitit 2016.

88. Arsyeja e pagesave *cash*, sipas z. M. M., ishte për faktin se objekti ka përfunduar në dhjetor 2014 dhe është deklaruar i përfunduar me faturë tatimore dhe kjo debi ka qenë ndaj, z. M. M., si individ të cilin e ka parapaguar nga ana e tij dhe kjo është arsyeja që nuk është lëshuar dhe kupon tatimor.

89. Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, iu kalua subjektit të rivlerësimit barra e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën. Për sa më sipër rezultoi se subjektin e rivlerësimit në deklaratën “Vetting” nuk ka deklaruar marrjen hua të shumës prej 2,700,000 lekësh nga “***” sh.p.k.

90. Subjekti ka shpjeguar se pjesa e mbetur gjatë vitit 2015 dhe 2016 janë kryer derdhje në *cash* shoqërisë “***” sh.p.k. sipas pagës mujore që ka tërhequr, e që në total për të dy vjet është vlera 2,720,000 (dy milionë e shtatëqind e njëzet mijë) lekë.

91. Derdhja në *cash* është kryer për arsye se shoqëria “***” sh.p.k., në fund të vitit 2014, e ka deklaruar të përfunduar në tatime me situacione objektin me vlerën 10,520,324 (dhjetë milionë e pesëqind e njëzetmijë e treqind e njëzetekatër) lekë dhe, për detyrimin e mbetur kanë rënë në marrëveshje që ta likuidonte sipas mundësive në *cash*.

Analiza ligjore

92. Në deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit, nuk e ka deklaruar si burim për krijimin e kësaj pasurie huan e marrë shoqërisë ndërtuese. Në nenin 4 të ligjit nr. 9049, në germën “dh” të tij, objekt i deklarimit, janë: “detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të

shprehura në lekë ose në valutë të huaj” dhe në shtojcën 2, të ligjit nr. 84/2016, në pjesën informuese të deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit, subjektet janë informuar mbi sanksionet në rast mosplotësimi me saktësi dhe vërtetësi të saj.

93. Nëse i referohemi edhe deklarimeve periodike vjetore, atë të viteve 2015 dhe 2016, kjo shifër është përmendur si detyrim (huaje) që subjekti i rivlerësimit i ka z. M. M., dhe jo si hua firmës ndërtuese, fakt i cili është i pasqyruar dhe likuiduar në vitet 2015 dhe 2016.

94. Pavarësisht kësaj deklarimi të pasaktë në deklaratat periodike nuk e përjashton subjektin nga detyrimi ligjor i deklarimit të këtij burimi të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën “Vetting”, sipas parashikimeve të nenit 30, të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me procesin e rivlerësimit të pasurisë, objekti i këtij vlerësimi është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të subjektit të rivlerësimit, elemente këto të cilat rezultojnë edhe nga deklaratimet periodike të pasurisë së subjekteve të rivlerësimit.

95. Në analizë të nenit 32, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: *“Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitur më parë pranë ILDPKI-së, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit”*. Duke qenë se përcaktimet kushtetuese dhe ligjore u kanë dhënë deklarimeve periodike të pasurisë vlerën e provës (paragrafi 42, i vendimit nr. 9, JR, datë 24.10.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit), ato mund të konsiderohen të së njëjtës rëndësi me deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, kalimtar, deklarata “Vetting”. Komisioni, këto deklarata së bashku me provat e tjera, i vlerëson në tërësi dhe në harmoni me rrethanat e çështjes, për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë.

96. Në referim të vendimit nr. 07, datë 25.09.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin për burimin e krijimit të kësaj pasurie, pasi në deklaratën “Vetting” nuk ka deklaruar si burim huan e marrë shoqërisë “****” sh.p.k., e cila në kuptim të parashikimeve të legjislacionit në fuqi, kjo hua ka shërbyer si burim i krijimit të kësaj pasurie.

97. Udhëzimi i ILDPKI-së, datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj.”, nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në pikat 7, 15, 18 dhe 22 përcakton: *“7. Për çdo pasuri në pronësi, të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj.”*

98. Formulari i deklarimit të pasurisë për procesin e rivlerësimit, në pjesën “Informacion në ndihmën tuaj”, përcakton: *“Detyrimi për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, e ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, e përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë të subjekteve, sanksionohet në ligjin “Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*”

99. Gjithashtu në këtë formular, në rubrikën “Deklarimi i pasurive”, sqarohet: “Objekti i deklarimit: *Të gjitha pasuritë e akumuluar ndë vite deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, sipas nenit 3, pika 11, e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në posedim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur. Përshkruani hollësisht: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve shumë e shpenzimeve që keni kryer, pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloj pasurie të regjistruar ose jo në regjistrat publikë.”*

Baza ligjore

100. Bazuar në provat dhe faktet e analizuar së bashku, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

- i. Ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin për burimin e krijimit të kësaj pasurie, pasi në deklaratën “Vetting” nuk është deklaruar si burim huaja e marrë shoqërisë “****” sh.p.k.
- ii. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit sipas nenit D, paragrafi 5, të Aneksit të Kushtetutës.
- iii. Bazuar në paragrafin 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë.

I/D NË LIDHJE ME BURIMIN E LIGJSHËM TË TË ARDHURAVE TË SUBJEKSTIT TË RIVLERËSIMIT PËR SHLYERJEN E DETYRIMIT NDAJ SHOQËRISË “**” SH.P.K.**

101. Si burim për shlyerjen e detyrimeve ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar hua në shumë prej 35,000 eurosh marrë me kontratë huaje, nr. ***, datë 07.01.2014, shtetasit D. P. me afat 10-vjeçar.

102. Bazuar në shkresën e QKB-së, nr. ***prot., datë 24.04.2018, rezulton se z. D. P. figuron:

- ortak zotërues i 50 % të kuotave në shoqërinë “****” sh.p.k., me NIPT ***, regjistruar më 13.12.2016;
- administrator dhe ortak zotërues i 80 % të kuotave të shoqërisë “****” sh.p.k., me NIPT ***, regjistruar më 06.04.2006, status i pezulluar;
- person fizik “****” me NIPT ***, regjistruar më 01.01.2003.

103. Në kryerjen e analizës financiare për mundësinë e z. D. P. për dhënien e huas subjektit të rivlerësimit në shumë prej 35,000 eurosh janë analizuar shkresa me nr. ***prot., datë 26.11.2018, dhe shkresa me nr. ***prot., datë 04.05.2018, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë të cilat kanë dërguar kopje të pasqyrave financiare të shoqërisë “****” sh.p.k. prej nga rezulton fitimi *neto* i realizuar ndër vite është përdorur për shtesë kapitali si më poshtë:

Vitet	Fitimi	Fitimet e pashpërndara	Kapitali aksionar	Shtesë kapitali	Dividenti
2006	338,896				0
2007	747,364	321,951			0
2008	652,573	1,069,315	100,000		0
2009	942,692	1,069,315	752,573	652,573	0
2010	893,750	1,069,315	1,694,573	942,000	0
2011	583,536	1,069,315	2,588,000	893,427	0
2012	491,925	1,069,315	3,168,000	580,000	0
2013	0	1,069,315	3,658,000	490,000	0
2014	151,846	1,069,315	3,658,000	0	0
2015	73,713		3,808,000	150,000	0
	4,876,295	1,069,315		3,708,000	0

104. Bazuar në të dhënat e administruara nga Drejtoria Rajonale Tatimeve Sarandë rezulton se z. D. P. është i regjistruar si tatimpagues në DRT Sarandë me emrin tregtar “***”.

Viti	Xhiro e deklaruar	Fitim i realizuar	Dividend i shpërndarë
2016	12,769,891	96,974	Jo
2017	55,104,657	977,593	jo

Arsyetimi ligjor

105. Në kuptim të nenit D, pika 3, e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të tij. Ndërsa neni 32, pikat 1 dhe pika 4, të ligjit nr. 84/2016 përcaktojnë përkatësisht: *“1. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive [...]”*. *“4. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse i konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive [...]”*

106. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse i konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. 5. Deklarimet e interesave privatë dhe pasurore, të paraqitura më parë pranë ILDKPKI-së mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit.

107. Udhëzimi i ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj.”, nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në pikat 7, 15, 18 dhe 22 përcakton: *“7. Për çdo pasuri në pronësi, të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, duhet të*

deklarojë burimin, në momentin e krijimit për secilin prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri, në momentin e fitimit të tyre”.

108. Deklarimi i huamarrjeve dhe i huadhënieve në likuiditete, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor dhe me vërtetimet bankare, në rast se veprimi në kohën e kryerjes së tij është kryer me transaksion bankar.

109. Nëse subjekti i rivlerësimit deklaron marrëdhënie me persona të tjerë të lidhur (fizikë dhe juridikë) në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit dhe huamarrësit, detyrohet të paraqesë dokumentacionin justifikues ligjor të lëshuar nga institucionet shtetërore dhe private për personat e tjerë të lidhur, referuar burimit të krijimit, të dhurimit, huadhënies dhe huamarrjes, dhënë subjektit të rivlerësimit.

110. Deklarimi si burim krijimi pasurie i të ardhurave nga aktiviteti privat i subjektit të rivlerësimit dhe/ose personave të lidhur me të, të shoqërohet për periudhën e deklaruar me dokumentacionin justifikues ligjor nga zyrat e tatim taksave për fitimin e realizuar dhe dividendin e tërhequr.

111. Formulari i deklarimit të pasurisë për procesin e rivlerësimit:

a. Në pjesën “Informacion në ndihmën tuaj”, përcakton: *“Detyrimi për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, e ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, e përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë të subjekteve”* të miratuar si shtojcë 2, e ligjit nr. 84/2016.

112. ILDPKI-ja, bazuar në deklaramet e pasurive, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Mbi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe ligjin nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative”.

b. Në pjesën “Deklarimi i pasurisë nga persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit”, përcakton: “Persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, në kuptim të nenit 3, pika 14, e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi.

113. Personat e tjerë të lidhur nëse konfirmojnë këto marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, mbartin detyrimin për deklarimin e pasurisë në Inspektoratin e Lartë, me kërkesë të Inspektorit të Përgjithshëm të Deklarimit të Pasurive të Paluajtshme.

114. Gjithashtu në këtë formular, në rubrikën “Deklarimi i pasurive”, sqarohet: *“Objekti i deklarimit: të gjitha pasuritë e akumuluar ndërr vite deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, sipas nenit 3, pika 11 e ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në posedim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur. Përshkruani hollësisht: llojin, sipërfaqen,*

adresën ku ndodhen, vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve shumë të shpenzimeve që keni kryer, pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloj pasurie të regjistruar ose jo në regjistrat publikë.”

115. Subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin ligjor të paraqitjes së dokumentacionit ligjor provues për të provuar se shtetasi D. P. ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për t'i dhënë huan në vlerën 35,000 euro.

116. Nga analiza ekonomike rezultoi se z. D. P. nuk ka përfituar të ardhura, pasi nuk është bërë shpërndarje të fitimit në formën e dividendit të shoqëria “****” sh.p.k. duke mos provuar se ka pasur në këtë mënyrë të ardhura të mjaftueshme për t'i dhënë hua shumë 35,000 euro subjektit të rivlerësimit.

117. Nga dokumentacioni ligjor provues i mësipërm, i siguruar nga hetimi administrativ, nuk është arritur të provohet ligjshmëria e të ardhurave të dhëna hua nga shtetasi D. P.

Baza ligjore

118. Bazuar te provat dhe faktet e analizuara së bashku, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

- i. Subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave të dhëna hua nga z. D. P., bazuar në nenin 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016.
- ii. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit sipas nenit D, paragrafi 5, të Aneksit të Kushtetutës.
- iii. Bazuar në paragrafin 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë.

II. NË LIDHJE ME:

Llogari Bankare në “Societe Generale Albania” në emër të znj. A. Sh., në shumë prej 225,465 lekësh.

Llogari Bankare në “Societe Generale Albania” në emër të znj. D. Sh., në shumë prej 228,962 lekësh.

119. Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”:

Kursime familjare. Bazuar në shkresën nga “Societe Generale Albania”, rezulton se:

1. Znj. D. Sh., ka depozitë pa afat deri në 18 vjeç në monedhën lekë me gjendje në vlerën 275,780.86 lekë. Depozita është hapur **në datën 24.10.2012**, me një shumë fillestare prej 62,500 lekësh. Në këtë llogari janë derdhur periodikisht shuma parash nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit.
2. Znj. A. Sh., ka depozitë pa afat deri në 18 vjeç në monedhën lekë me gjendje në vlerën prej 272,105.52 lekësh. Depozita është hapur **në datën 24.10.2012**, me një shumë fillestare prej

62,500 lekësh. Në këtë llogari janë derdhur periodikisht shuma parash nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit.

3. Në datën 28.03.2012 bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka lidhur kontratë kredie kufi *overdraft* për shumën prej 97,800 lekësh, kjo hua nuk rezultoi e deklaruar në deklaratën “Vetting”.

120. Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit deklaroi se babai i bashkëshortes së subjektit i ka dhuruar dy vajzave të tij shumën prej 160,000 lekësh depozitë në “Bankën Popullore”.

121. Në datën 15.09.2017 në të dyja depozitat e mësipërme është depozituar shuma prej 10,000 lekësh me emërtesë “K. Z., derdhje depozite” dhe në datën 12.02.2018 në të dyja depozitat e mësipërme është depozituar shuma prej 25.000 lekësh me emërtesë “K. Z., derdhje nga Xh. Z”.

122. Gjendja e llogarive bankare (depozita) në emër të vajzave në “Societe Generale Albania”.

Gjendja e llogarive bankare në fund të vitit	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016
D. Sh.	75,173	101,722	141,919	195,581	218,963
A. Sh.	73,165	96,581	136,500	190,302	215,465

123. Nga sa më sipër, trupi gjyqësor, vlerësoi se shpjegimet e subjektit ishin të plota për këto llogari bankare, dhe ka një pasaktësi në deklaratim, lidhur me vlerën e paraqitur për këto llogari në deklaratën “Vetting”, por nga hetimi administrativ nuk rezultuan dyshime të mëtejshme lidhur me të dhënat e administruara për këto llogari në emër të vajzave të tij.

Konkluzioni për vlerësimin pasurisë

124. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjyqësor, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Çlirim Shahini, ka kryer deklaratim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë. Subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ me shpjegimet dhe provat e paraqitura prej tij, dhe të bindë trupin gjyqësor mbi pavërtetësinë e rezultateve të hetimit. Në zbatim të pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës ndaj saj zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

Bazuar në paragrafin 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratim të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë.

III. Nga ana e Komisionit është administruar e analizuar ankesa e shtetasit z. B. Ç.

125. Komisioni ka administruar ankesën e shtetasit B. C., i cili deklaroi se subjekti i rivlerësimit ka pushuar padrejtësisht çështjen e plagosjes së djalit të tij dhe ka dërguar për gjykim padrejtësisht djalin e tij. Nga verifikimi i ankesës u konstatua se kishte nevojë për hetim të mëtejshëm. Me shkresën nr. *** prot., datë 04.10.2018, i jemi drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, për të kërkuar kopje të fashikujve të procedimit penal nr. ***dhe nr. ***. Në datën 8.10.2018, me shkresë ***prot., Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit

Gjyqësor Saranda, na ka vënë në dispozicion fashikujt e procedimeve të mësipërme. Nga analizimi i këtyre fashikujve rezulton se:

126. Në datën 19.03.2012 është regjistruar procedimi penal nr. ***, akuza: “Vjedhje parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve A. S., V. S., K. S., R. Ç.”.

Bazuar në informacionin për referimin e veprës penale të datës 19.03.2012, rezulton se:

“Shtetasit K. S., A. S., V. S., B. Ç. kanë vjedhur në bashkëpunim një pajisje automjeti, kamio autobusi, e cila gjendej në banesën e shtetasit F. K.... Ky shtetas ka qëlluar në fillim në ajër dhe më pas në drejtim të gomave të mjetit, por ka rrëshqitur dhe nuk ka ditur se ku kanë shkuar saçmat e çiftes dhe nuk ka marrë vesh se çfarë ka ndodhur me personat...Gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes janë frikësuar dhe marrë në cilësinë e provës dy gëzhoja armë gjahu dhe një fishek armë gjahu, për të cilat është bërë dhe vendimi për ekspertim teknik balistik së bashku me armën e gjahut. Nga këqyrja e automjetit ka rezultuar se në pjesën e pasme të tij është frikësuar një njollë me ngjyrë të kuqe si ajo e gjakut, e cila është marrë me një tampon steril dhe për të është përpiluar vendimi për ekspertim biologjik. Është bërë kontrolli i banesës së shtetasit I. K., ku i është sekuestruar një armë gjahu...”

Shtetasi B. Ç. gjendet i shtruar në Spitalin Ushtarak Tiranë dhe do të ndiqet në gjendje të lirë për të njëjtën vepër penale.

Shtetasi F. K. do të ndiqet në gjendje të lirë për veprën penale “Plagosje e lehtë me dashje” dhe “Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive” të parashikuar nga nenet 89 dhe 280 të Kodit Penal...”

127. Në procesverbalin e datës 18.03.2012, të këqyrjes së vendit të ngjarjes, thuhet: *Këqyrja u shoqërua me fotografitë e nevojshme kriminalistike, mungojnë fotografitë. Këqyrja është bërë në kushtet të mira atmosferike dhe me ndriçim natyral. Nga procesverbali rezulton se rruga është e shtruar me asfalt, pa mbetje inerte. Në procesverbalin për këqyrjen e mjetit, datë 18.03.2012, thuhet: Këqyrja u shoqërua me fotografimet përshtatëse, mungojnë fotografitë. Në procesverbalin për këqyrjen dhe marrjen e provës materiale datë s’ka në të cilin thuhet: Këqyrja u shoqërua me fotografitë e nevojshme, mungojnë fotografitë. Në procesverbalin për këqyrjen dhe marrjen e provës materiale, datë 18.02.2012, në të cilin thuhet: Këqyrja u shoqërua me fotografitë e nevojshme, mungojnë fotografitë.*

Shtetasi F. K. bazuar në procesverbalin e marrjes së të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet, të datës 18.03.2012, ka deklaruar si më poshtë: *“... pasi kam zbritur te shtëpia kam parë një makinë tip furgon, me ngjyrë të bardhë, me targa ***... Unë kam dashur t’i tremb dhe kam shtirë në ajër një herë dhe një herë kam dashur që t’u shpoj gomat, dhe (ka një paragraf bosh) nuk di të kem qëlluar drejt dhe të kem qëlluar ndonjë person pasi ishte dhe natë...”*

128. Bazuar në aktin e ekspertimit nr. ***, datë 23.04.2012, “Ekspertim tekniko-balistik arme dhe dy gëzhoja”, rezulton se:

*Nga ekzaminimi krahasues është konstatuar mospërputhje e gjurmëve, dy gëzhojat njëra kal. 12 dhe tjetra kal. 16 janë qitur nga dy armë zjarri të ndryshme. Nga ekzaminimi krahasues që u krye me mikroskopin stereoskopi dhe krahasues “****”, është vënë re se gjurmët e formuara në gëzhojën me trup me ngjyrë blu “****, 30 gr”, kal, 12 është qitur nga tyta e majtë e armës së zjarrit çifte e markës “****”, me nr. ***, ndërsa gëzhoja me kalibër 16 nuk është qitur nga kjo armë zjarri.*

129. Bazuar në aktin e ekspertimit rezulton se gëzhojat e gjendura në vendin e ngjarjes janë qitur nga dy armë të ndryshme. Në lidhje me këtë fakt rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë asnjë veprim hetimor për të evidentuar se kush ka qitur me armën e dytë dhe kujt i përket kjo armë.

130. Bazuar në kërkesën për vleftësimin e arrestit dhe caktimit të masës së sigurisë të datës 20.03.2012 subjekti i rivlerësimit është shprehur si më poshtë: *“Nga deklarimi i marrë shtetasit I. K... Në këtë moment F. ka qëlluar në fillim në ajër me armën e gjahut dhe më pas ka qëlluar në drejtim të gomave të mjetit, por nga terreni dhe kushtet e errësirës ka rrëshqitur dhe në një moment arma i është shkrepur pa kontrolluar drejtimin e qitjes dhe nuk ka parë se çfarë drejtimi kanë përshkruar saçmat e çiftes...”*

131. Ky deklarim nuk rezulton të jetë bërë nga ana e shtetasit I. K. mbështetur në deklaramet e dhëna nga ky shtetas në procesverbalin e marrjes së të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, të datës 18.03.2012, nga ku rezulton se shtetasi I. K. ka deklaruar: *“...Pas disa minutash unë kam dëgjuar një të shtënë arme. Në këtë moment pashë një automjet që po largohej. Pasi automjeti u largua F. erdhi në shtëpi...”* ndërsa në procesverbalin për deklarimin nga personat që tregojnë rrethanat e hetimit të datës 17.04.2012, rezulton se z. I. K. ka deklaruar: *“...unë kam shkuar disa minuta me vonë te vendi i ngjarjes, në çastin që furgoni është larguar. Pa arritur ende te F. kam dëgjuar një të shtënë me armën e gjahut. Pyeta F. se çfarë ndodhi dhe F. më tha se qëllova një herë në ajër për shkak se personat nuk iu bindën të qëndronin dhe ishin larguar... Nga kontakti me nipin F. ai më tha se qëllimi i tij ishte t'i trembte, duke shtënë në ajër me armën e gjahut, ndoshta ndonjë nga saçme e armës së gjahut e ka kapur ndonjë nga personat”*.

132. Në lidhje me këtë moment pra, të rrëshqitjes së shtetasit F. K., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, në vendimin nr. ***, të datë 09.06.2013, nuk shprehet fare duke konkluduar se: *“...Nëse qëllimi i këtij shtetasi do të kishte qenë plagosja e personave që i kishin vjedhur kamion e autobusit, ai i kishte të gjitha mundësitë të shtinte në drejtim të tyre, ndërkohë që ia ka shtirë dy herë, një herë në ajër dhe një herë në drejtim të furgonit, por pa pasur një objektiv të paracaktuar”*.

133. Nuk referohet se ku është bazuar subjekti i rivlerësimit për të dalë në konkluzionin se, z. F.K., ka rrëshqitur.

Në datën 04.06.2012 është mbajtur procesverbali për deklarimin nga personi që tregon rrethana hetimi në emër të shtetasit R. Ç. ky emër nuk është i saktë pasi bazuar në aktet e dosjes emri i saktë i shtetasit është B. Ç. Ky procesverbal nuk rezulton i firmosur nga oficeri i policisë gjyqësore, në kundërshtim me nenin 117³ të Kodit të Procedurës Penale. Ky fakt nuk është konstatuar nga subjekti i rivlerësimit, i cili duhet të vendoste deklarimin e pavlefshëm të këtij akti. Ndërkohë për këtë procesverbal është shprehur Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, në vendimin nr. ***, datë 29.04.2013: *“Gjykata me vendim të ndërmjetëm vendosi të deklarojë si relativisht të pavlefshëm procesverbalin e datës 04.06.2012 të marrjes në pyetje të të pandehurit*

³ Procesverbali, me përjashtim të atij që mbahet në seancën gjyqësore, pasi lexohet, nënshkruhet në fund të çdo flete nga ai që e ka përpiluar, nga ai që procedon dhe nga personat që kanë marrë pjesë. 2. Kur njëri nga pjesëmarrësit nuk do ose nuk është në gjendje të nënshkruajë, bëhet vërejtje ku tregohet edhe shkak.

B. Ç., pasi ka çmuar se ky procesverbal nuk është firmosur nga oficeri i policisë gjyqësore që ka marrë në pyetje këtë shtetas”.

134. Subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë vepruar në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale, duke mos vendosur deklarinimin e pavlefshëm të aktit: “Procesverbal i datës 04.06.2012 të marrjes në pyetje të të pandehurit B. Ç.”

Në datën 19.06.2012 subjekti i rivlerësimit ka vendosur zgjatjen e hetimeve për procedimin penal, nr. ***, me arsyetimin se hetimit për këtë procedim penal nuk kanë përfunduar ende për arsye objektive, por pa u shprehur se cilat janë arsyet. Ky vendim për zgjatjen e afateve nuk rezulton t’i jetë njoftuar të pandehurve K. S.dhe F. K., në kundërshtim me nenin 324/3⁴ të Kodit të Procedurës Penale.

Subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale, duke mos i njoftuar të pandehurit për zgjatjen e hetimeve.

135. Bazuar në procesverbalin për njohjen e të pandehurit me materialet e çështjes, të datës 19.09.2012, nga përmbajtja e tij rezulton se nuk është i qartë identitetit i të pandehurit, pasi në paragrafin e parë emri i të pandehurit është B. Ç., në paragrafin e dytë është K. S., ndërkohë që i pandehuri firmos si R. Ç.

136. Në datën 19.09.2012 subjekti i rivlerësimit ka vendosur veçimin e materialeve të procedimit penal nr. ***, të vitit 2012. Edhe në këtë vendim subjekti i rivlerësimit i referohet shtetasit B. Ç. si R. Ç. Arsyeja e veçimit të materialeve të procedimit penal nr. *** (i cili ka marrë nr. ***), regjistruar për kundërvajtje penale: “Plagosje e lehtë me dashje” dhe “Prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”, të parashikuar nga nenet 89 dhe 280 të Kodit Penal në emër të z. F. K., ka qenë mosadministrimi ende i aktit të ekspertimit mjekoligjor dhe mosbërja e tij pjesë e fashikullit.

137. Në datën 19.09.2012 subjekti i rivlerësimit ka vendosur zgjatjen e afateve hetimore për procedimin penal nr. *** me arsyetimin se akti i ekspertimit mjekoligjor për të dëmtuarin R. Ç. nuk është administruar ende. Ky vendim për zgjatjen e afateve nuk rezulton t’i jetë njoftuar të pandehurit F. K., në kundërshtim me nenin 324/3⁵ të Kodit të Procedurës Penale. Për më tepër ky vendim nuk duhej të bëhej për procedimin me nr. ***, pasi në datën 19.09.2012 subjekti i rivlerësimit ka vendosur veçimin e materialeve të procedimit penal nr. ***, të vitit 2012, në ngarkim të shtetasit F. K.

138. Në datën 15.11.2018, Komisioni i ka dërguar shkresën me nr. *** prot., Institutit të Mjekësisë Ligjore, i cili, në datën 20.11.2018, me shkresë nr. ***, na ka vënë në dispozicion: Vendimin e datës 08.01.2013, “Për kryerje ekspertimi mjekoligjor” të nxjerrë nga subjekti i rivlerësimit.

Bazuar në aktin e ekspertimi mjekoligjor nr. ***, datë 21.01.2013, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesën për kryerjen e aktit të ekspertimit në datë 08.01.2013.

⁴ Vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve u njoftohet të pandehurit dhe të dëmtuarit.

⁵ Vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve u njoftohet të pandehurit dhe të dëmtuarit.

139. Subjekti i rivlerësimit ka zgjatur dy herë afatet e hetimit pa arsye pasi nga ana e tij nuk ishte dërguar ende kërkesa për ekspertim mjekoligjor.

140. Në datën 30.01.2013 subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e hetimeve të çështjes penale nr. ***, në ngarkim të shtetasit F. K.. Arsyet e pushimit kanë qenë pasi të dy veprat penale për të cilin akuzohej ky shtetas përkatësisht të “Plagosjes së rëndë nga pakujdesia” dhe “Prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive” parashikuar nga nenet 91 dhe 280 janë të përjashtuara nga ndjekja penale bazuar në ligjin nr. *** datë 8.11.2012, “Për dhënie amnistie”.

141. Nga vlerësimit tërësor i këtij procedimi rezulton se nga ana e subjektit të rivlerësimit janë shkelur dispozitat e Kodit të Procedurës Penale pasi janë shtyrë pa arsye afatet e hetimit, vendimi për ekspertimin mjekoligjor të shtetasit B. Ç. është nxjerrë gati një vit pasi ka ndodhur ngjarja, si dhe është përdorur si arsye për shtyrjen e afateve hetimore, procesverbali i datës 04.06.2012 i marrjes në pyetje të të pandehurit B. Ç. nuk ka qenë i rregullt, si dhe është e paqartë se ku është bazuar subjekti i rivlerësimit për të dalë në konkluzionin se z. F. K. ka rrëshqitur.

142. Pas kalimit të barrës së provës së mësipërme subjekti i rivlerësimit dha shpjegimet e tij, por nuk referoi në asnjë provë për sa i përket konkluzionit të tij se z. F. K. ka rrëshqitur, por ai argumenton se i është referuar raportit të OPGJ-së. Raporti i OPGJ-së është sugjerues për më tepër për të dalë në një konkluzion të tillë, i cili është i rëndësishëm për të dalë në konkluzion nëse ishim në kushtet e plagosjes së rëndë nga pakujdesia. Subjekti i rivlerësimit nuk dha asnjë argument se përse i ka shtyrë dy herë afatet e hetimit me motivacionin në pritje të aktit të ekspertimit mjekoligjor pa nxjerrë më parë vendimin për ekspertimin mjekoligjor.

Në vlerësim tërësor të dy kritereve, pasurisë, figurës dhe denoncimit të mësipërm, sa më sipër analizuar e arsyetuar, në vendim, trupi gjykues vlerëson se Subjekti i rivlerësimit, ka cënuar rëndë besimin e publikut tek drejtësia, në kuptim të pikës 5 të nenit 61 të ligjit 84/2016.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Në analizë të deklaramit të subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e Pasurisë, “Vetting”, (i) raportit të hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratave periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (ii) raporteve të DISK-së; (iii) provave shkresore nga DSIK-ja; (iv) formularit për kontrollin e figurës, dorëzuar nga subjekti pranë DSIK-së, provave shkresore të administruara nga Komisioni, denoncimeve, shpjegimeve dhe provave të dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ; trupi gjykues arrin në përfundimin se:

- i. Bazuar në paragrafin 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaramit të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaramit të pasaktë sipas pikës të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës së Shqipërisë, pasi ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, në mënyrë të pasaktë, duke u përpjekur të fshehtë kontaktet me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

- iii. Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave sipas pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.
- iv. Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose për të evidentuar në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi të tij, sipas pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.
- v. Bazuar në paragrafin 5 , të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 Subjekti i rivlerësimit, ka cënuar rëndë besimin e publikut tek drejtësia.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenet 179/b, te Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, si dhe në nenin 61, pika, 3, dhe pika 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”:

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Çlirim Shahini, prokuror dhe drejtues pranë Prokurorisë së Rrethit Lushnjë.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë pas përfundimit të seances dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 26.03.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda Bekteshi
Kryesuese

Anëtare
Suela Zhegu

Relatore
Xhensila Pine

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj